



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2019:193963

Datë: 03.02.2023

Numri i dokumentit: 03993714

**C.nr.996/19**

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ**, Departamenti Përgjithshem-Divizioni Civil, gjyqtari Bekim Salihu, me bashkëpunëtorin profesional Meriton Zeqiri, në çështjen juridike të paditësve Q.U., N.U., B.U. dhe R.U. nga fshati ....., Komuna Ferizaj, të cilët i përfaqëson me autorizim Ali Kryeziu avokat nga Prishtina, Sheshi “Bill Klinton” 97 Dardanai, kundër të paditurve M.D. nga fshati ....., Komuna Hani i Elezit, Kompania e Sigurimeve “S.“, me seli në Prishtinë rr. “...” nr. ...., Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), rr. “e Pejës” dhe Byroja Nacionale e Sigurimeve të Maqedonisë Veriore, me seli në Shkup rr. “Mitropolit Gologanov no. 28/3”, lidhur me kompensimin e dëmit material-rentës, në seancën e mbajtur me datë 22.11.2022, në praninë e të autorizuarit të paditësve dhe të autorizuarve të paditurve mori, ndërsa me datën 26.01.2023 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **REFUZOHET në tërësi**, kërkesëpadia e paditësve Q.U., N.U., B.U. dhe R.U. nga fshati ....., Komuna Ferizaj, me anë të cilës kanë kërkuar që të DETYROHET të paditurit M.D., Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli në Prishtinë, që paditësve, në emër të kompensimit të dëmit material-rentës si rezultat i vdekjes së R.U., në aksidentin e datës 12.09.2016, **në emër të rentës**, për periudhën kohore nga data 12.09.2016 deri me datën 31.10.20220 për paditësit shumën prej **24,603.72€**, kurse në emër të rentës duke filluar nga data 01.11.2022 e deri sa të ekzistojn kushtët ligjore, për çdo muaj duke filluar nga data 01 deri më datën 05 të çdo muaji, shumën prej 268 euro, për paditësen Q.U. dhe paditësen N.U., me kamatën ligjore pre 8%, nga data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej

5,047.00€, të gjitha këto ne afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë **si e pabazuar**

- II. HEDHET POSHTË** kërkesëpadia e paditësve Q.U., N.U. B.U. dhe R.U., ndaj të paditurës Byroja Nacionale e Sigurimeve të Maqedonisë Veriore, **si e palejuar**.
- III.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

### **A r s y e t i m i**

Paditësit, përmes të autorizuarit të tyre kanë ushtruar padi në gjykatë me datën 04.09.2019, kundër të paditurve M.D. nga fshati ..., K.Hani i Elezit, Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë, Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë dhe Byroja Nacionale e Sigurimeve të Maqedonisë Veriore, me seli në Shkup, për kompensimin e dëmit jo material të shkaktuar nga aksidenti i datës 12.09.2016, i shkaktuar nga M.D.

Gjykata në seancën e datës 21.03.2022, e ka hedhë poshtë padinë e paditësve, si të pa lejueshme ndaj K.S. “S.” me seli në Prishtinë, për shkak të litispedencës, pasi që e njëjta çështje është gjykuar sipas aktgjykimit C.nr.797/16, i datës 06.06.2019 dhe lënda gjendet me ankesë, dhe procesi gjyqësor ka vazhduar me të paditurit e tjerë.

Paditësit, përmes të autorizuarit të tij av.Ali Kryeziu, kanë deklaruar se: mbesim pranë parashtrësës tonë më të cilën kemi kërkuar që në mënyrë solidare të padituritë të i kompensojnë dëmin paditësve lidhur me mbajtjen e humbur-rentën, mbështetur në ekspertizën e aktuarit A.B., të datës 04.11.2022, me të cilën ekspertizë është përcaktuar renta e arritur nga dita e aksidentit 12.09.2016 e deri më datën 31.10.2022, kur është bërë hartimi i ekspertizës të ju paguhet shuma prej 24.603.72 euro, në të cilën shumë është inkorporuar edhe kamata e specifikuar me parashtrësë, dhe nga data 01.11.2022 e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore të ju paguhet renta mujore në lartësi prej 268 euro muaj, apo në formë të kapitalizune në rast të arritjes së marrëveshjes në shumë prej 22.087.08 euro, apo në formë të kapitaluar që përfshinë rentën e arritur dhe rentën në të ardhmen e precizojmë në lartësi prej 46.690.80 euro, ashtu siç është llogaritar nga aktuari, po ashtu kërkojmë nga gjykata që të na i njej shpenzimet e procedurës të i precizuara me parashtrësë, në shumë të përgjithshme prej 5.047.00 euro. Meqenëse baza juridike e kërkesë padisë nuk është kontestuese, nuk është kontestuese edhe

legjitimiteti pasiv i të paditurve, kompetenca territoriale e kësaj gjykate, si dhe lartësia e kompensimit të dëmit, kërkojmë nga gjykata që të marrë vendim të drejtë bazuar në pretendimet tona të paraqitura me këtë parashtrësë. Behet fjalë për një kompensim dëmi të ndodhur në vitin 2016 dhe ende familja e dëmtuar nuk arrin të kompensohet në tërësi lidhur me humbjen e anëtarit të familjes-bashkëshoritit dhe babait të palëve paditëse.

I padituri M.D., ka deklaruar: Mbes në tërësi pranë deklaramëve të mëparshme, duke e kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesë padinë e paditësve për shkak të mungesës së legjitimitetit, pasi që unë kam pas mbulesë sigurise nga K.S. "S." po ashtu unë për vepër jam gjukuar në gjykatën e Shkupit si dhe nuk i kërkoj shpenzimet e kësaj procedure.

E autorizuar e të paditurës BKS, L.Rr., ka deklaruar: Mbetemi në tërësi pranë thënieve të lartcekura duke e kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesë padinë e paditësve për shkak të mungesës së legjitimitetit ndaj të paditurës, duke u bazuar në Memorandumin e bashkëpunimit në mes të BKS-se dhe Byrosë Nacionale të Sigurimeve të Maqedonisë Veriore, si rezultat që aksidenti ka ndodhur në fshatin ..., pra në teritorin e Republikës së Maqedonisë Veriore.

I autorizuari i të paditurit Byroja Nacionale e Sigurimeve të Maqedonisë Veriore ka deklaruar: fjalën përfundimtare e kemi në formë të shkruar të cilën ja dorëzojmë gjykatës dhe palëve në procedurë, dhe qëndrojmë në tërësi pranë të njëjtës duke shtuar se aksidenti ka ndodhur në Maqedoni, në rrugën kryesore Shkup-Bllacë dhe sipas momorandumit të nënshkruar dhe të ratifikuar ndërmjet paditurës së tretë dhe të katërt në kapitullin 3 është paraparë që pagesa e dëmit është nën juridiksionin e Republikës së Maqedonisë Veriore, sepse dëmi ka ndodhur në Republikën e Maqedonisë Veriore, si rezultat i kësaj duhet zbatohen ligjet Maqedonase dhe jo të Kosovës, dhe se paditësit duhet paraqitur kërkesë për shpërblim dëmit në Byrojen Nacionale të Sigurimeve në Maqedoninë Veriore dhe në rast se dëmi nuk procesohet duhet të paraqitet padi, duke I propozuar gjykatës që ta refuzoj padinë e paditësve për shkak se e njëjta nuk është as garantuese dhe as paguse përfundimtare e kompensimit të dëmit të shkaktuar nga automjeti i huaj që ka mbulesë të vlefshme sigurimi- karton të gjelbërt, si dhe nuk i kërkojmë shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike të çështjes, për aq sa palët ndërëgjyjëse i parashtruan ato në këtë procedurë, bazuar në nenin 7.1 të LPK-së, ka bërë adminsitrimin e provave si vijojnë – *Ekspertizën aktuaristike për lëndën C.nr. 797/16, e datës*

*13.03.2019, e hartuar nga aktuari A.B. dhe Plotësimi i ekspertizës aktuaristike C.nr. 996/19 e datës 13.03.2019, e përpiluar ne datë 04.11.2022.*

Gjykata, pas administrimit të provave, ka bërë shqyrtimin e tyre veç e veç si dhe të ndërlidhura si tërësi mes veti, mbi bazën e bindjes së saj të lirë në kuptim të nenit 8 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, ka gjetur se duhej vendosur si në dispozitiv.

Në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti se tani paditësit janë pasardhësit e tani të ndjerit R.U.

Për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata sipas propozimit të palëve ka nxjerr provën material me leximin e mendimit dhe konstatimit të ekspertit aktuar A.B., për lëndën C.nr. 797/16, e datës 13.03.2019 dhe Plotësimin e ekspertizës aktuaristike C.nr. 996/19, e datës 13.03.2019, e përpiluar me datë 04.11.2022, gjykata ka vërtetuar se lartësia e rentës-mbajtjes për paditësit, për periudhën kohore nga data 12.09.2016 deri me datën 31.10.20220, shumën prej 24,603.72€, e cila shumë është si rezultat i vdekjes së bashkëshortit-babait të paditësve R.U., kurse lartësia e rentës duke filluar nga data 01.11.2022 tutje, deri deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, për çdo muaj shumën prej 268.00 euro, për paditësen Q.U. dhe për paditësen N.U.

Gjykata edhe pas administrimit të provave material nuk mundi të aprovoj padinë e paditësve ndaj të paditurëve M.D. dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), si rezultat se në mes palëve ndërgjyqëse është kontestuese legjitimiteti real pasiv për të qenë palë të paditura në këtë procedurë.

Gjykata, vlerëson se M.D., nuk ka legjitimitet real pasiv, për të qenë palë e paditur sepse duke u bazuar në nenin 3 par. 1, lidhur me nenin 9 par. 1.1 dhe lidhur me nenin 31 par. 1, në lidhje me par. 4 pika 4.2 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia i Kosovës, pasi që mjete motorik i tij ka qenë i siguruar dhe ka pas karton të gjelbertë për mbulesë të dëmeve, e që aksidenti në fjalë gjegjësisht demi është shkaktuar jashtë territorit të vendit tonë.

Gjykata, vlerëson se Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), nuk ka legjitimitet real pasiv, për të qenë palë e paditur sepse duke u bazuar në Memorandumin e arritur në mes të Byrosë Kosovare të Sigurimit dhe Byrosë Nacionale të Sigurimeve të Maqedonisë Veriore, përmes kësaj marrëveshje është paraparë që të gjitha dëmet e shkaktuara brenda në territorin e

Republikës së Maqedonisë Veriore, kompetente për të kompensuar të gjitha dëmet e shkaktuara është Byroja Nacionale e Sigurimëve e Maqedonisë Veriore.

Gjykata vlerëson se për të paditurën Byroja Nacionale e Sigurimeve të Maqedonisë Veriore duhet hudhë poshtë padia si e palejuar sepse , duke u bazuar në nenin 18.3 ”Kur gjykata gjatë zhvillimit të procedurës konstaton se për zgjidhjen e kontestit nuk është kompetente gjykata e vendit, do të shpallet inkompetente, do t'i anulojë veprimet procedurale të kryera dhe do ta hedhë poshtë padinë. Mirëpo, gjykata nuk do të veprojë ashtu nëse kompetenca e gjykatës së vendit tonë varet nga pëlqimi i të paditurit, e i padituri e ka dhënë pëlqimin e vet”, ndërsa në nenin 39 pika 2 të LPK-së është parapar që “për gjykimin në kontestet kundër personave juridik të tjerë, e kompetencës së përgjithshme territoriale është gjykata në territorin e të cilës ndodhet selia e tyre e regjistruar”. Po ashtu edhe me dispozitën e nenit 47 pika 1 të LPK-së është parapar që “Për gjykim në kontestet lidhur me përgjegjësinë jokontraktuale për demin, përveç gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale, është kompetente edhe gjykata në territorin e së cilës është kryer veprimi dëmtues apo gjykata në territorin e së cilës ka lindur pasoja e dëmtimit” bazuar në këtë gjykata vlerëson faktin se padia duhet të paraqitet në Shtetin e Maqedonisë Veriore, pasi që kem të bëjm me një shtet tjetër dhe gjykata e vendit smundët të gjykoj dhe të obligoj një person juridik që e ka selin në vendin-shtetin tjetër, e që gjykohët çështja me dispozita ligjore- legjislacion të një shteti tjetër.

Si dhe duke u bazuar në marrëveshjen “MOU”, me “nr.0710-2490/12, dt.24.10.2012 dehe nr.1411/12, dt.30.10.2012”, të lidhur në mes të Byroja Kosovare e Sigurimit dhe Byrosë Nacionale të Sigurimeve të Maqedonisë Veriore, është përcaktuar që të gjitha dëmet e shkaktuara në teritorin e Republikës së Maqedonisë Veriore duhet të kompensohen nga Byroja Nacionale e Maqedonisë, fakt të cilin e njejta e ka theksuar në fjalën përfundimtare në pasuesin e tretë ku përmend kapitullin 3, të kësaj marrëveshje.

Andaj gjykata vlerëson që paditësit këtë padi duhen të e paraqesin pranë gjykatës kompetente të shtetit të Maqedonisë së Veriut, e që sipas legjislacionit në fuqi të këtij shteti, ndaj të paditurës Nacionale të Sigurimeve të Maqedonisë Veriore, si byro kompetente.

Gjykata lidhur me provat tjera të administruara dhe thënjet e palëve të cilat nuk i elaboroi, vlerëson se të njejta nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë aktgjykim.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës është bazuar në nenin 450 të LPK-së, vendosi që secila palë të i bartë shpenzimet e veta procedurale, pasi që pala paditëse e ka humbur kontekstin, ndërsa të paditurit shpenzimet nuk i kanë kërkuar shpenzimet.

Andaj, gjykata bazuar ne nenin 2,5, 18.3,39.2, 47,142, 143 dhe 160 të LPK-së dhe 3,9 e 31, të LSDA, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ**  
**C.nr.996/19 date 26.01.2023**

**Gjyqtari,**  
**Bekim Salihu**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të kopjes së tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.